



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 5, datë 31.01.2024

MBI
FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2024

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35 e vijues të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë dhe për zbatim të nenit 35, pika 7, e ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen funksionet e entit kompensues për kryerjen e pagesave të dëmeve të parashikuara në nenin 41 të këtij ligji dhe kontributet e nevojshme për pagesën e këtyre dëmeve përballohen nga Fondi i Kompensimit.

Në zbatim të nenit 41, pika 4, të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit.

Gjithashtu, në bazë të nenit 40, të ligjit nr. 32/2021, shoqëritë e sigurimit krijojnë dhe mbajnë provigjonet e dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 41, të këtij ligji.

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 313 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën nr. 232 prot., datë 23.01.2024, depozitoi në Autoritet vendimin nr. 1, datë 22.01.2024 “Për miratimin e masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2024”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Për vitin 2024, masa e kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2024, të jetë në vlerën 270,000,000 lekë.
2. Provigjonet e dëmeve të Fondit të Kompensimit për rastet e përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, do të krijohen në vlerën prej 613,763,321 lekë, të cilat do të pasqyrohen nga shoqëritë e sigurimit, në pasqyrat financiare të vitit 2023.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit:
 - 3.1. Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të Fondit të Kompensimit sipas pikës 1, të këtij vendimi;
 - 3.2. Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive për krijimin e provigjonit për shpenzime sipas pikës 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Departamentet përkatëse, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

NËNDREJTOR EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI